



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 11 prill 2012

Panel diskutim dhe fillim i projektit të financuar nga EIDHR:

“Qasja në informacione – burim i informatave më cilësore”

11 prill 2012, Qendra Informative e BE-së

Fjalim

**Ekselencia e tij Z. Aivo Orav,
Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian**

Të nderuar përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile,

Zonja dhe zotëri,

Është kënaqësi që Delegacioni i BE-së është nikoqir i panel diskutimit të sotëm me rastin e instrumentit për qasje në informacione.

Ngjarja e sotme shënon fillimin e projektit të financuar nga BE-ja në kuadër të Instrumentit për demokraci dhe të drejtat njerëzore (EIDHR). Objektiva e tij është që ta përforcoj përdorimin e instrumentit për qasje në informacione nga medita, me këtë duke kontribuar për cilësinë e raportimit të tyre si edhe për forcimin e mediave të pavarur.

E drejta për qasje në informacionet publike u jep qytetarëve mundësi të marrin pjesë në jetën publike, të ndihmojnë në krijimin e prioritetëve, dhe ta mbajnë të përgjegjshme qeverinë. Ushtrimi i kësaj të drejte është e domosdoshme për mediat dhe shoqërinë civile për monitorimin e punës së autoriteteve publike dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes.

Qarkullimi i lirë i informacioneve është vegël e rëndësishme për ndërtimin e besimit midis qeverisë dhe qytetarëve, duke e bërë administratën publike më efikase në dhënien e shërbimeve. Ajo inkurajon qytetarët që ti shqyrtojnë dhe vlerësojnë aktivitetet e autoriteteve publike por edhe përdorimin me efektiv të të drejtave tjera politike dhe publike.

Një numër të madh të gjykatave nacionale dhe ndërkombëtare kanë konfirmuar se **qasja në informacione që i kanë institucionet publike është e drejtë njerëzore fundamentale** sikur që është përfshirë në Nenin 10 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut që e mbron lirin e të shprehurit, e pranuar edhe nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut.

Në BE kjo e drejtë është e përfshirë në Nenin 15 të Traktatit të Bashkimit Evropian, po instrumenti qendror për këtë qëllim është Rregullorja 1049/2001 të parlamentit Evropian dhe Këshillit, i cili i vendos modalitetet për të drejtën e qasjes në dokumentet e BE-së dhe e rregullon transparencën të procedurave për shpalesje.

Më tej, një nga **veprat më të fuqishme për opinionin janë ligjet për qasje në informacione** të cilat tani ekzistojnë në shumicën e shteteve të Evropës, shumica nga tyre i kanë miratuar para pak kohë dhe duhet të shfrytëzohen nga media.

BE-ja e përshëndet implementimin e vazhdueshëm të Ligjit për qasje në informacionet publike (2006). **Por, Qeveria akoma duhet ta përforcoj instrumentin, sikur që është theksuar në raportin e Progresit 2011:**

- Legjislacioni ekzistues për qasje në informacione publike duhet të plotësohet me qëllim që të sigurohet transparencë të plotë;
- Mekanizma për kontroll të brendshme të administratës publike duhet akoma të përmirësohen;
- Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë të informacioneve publike ka nevojë për ndihmë të rëndësishme financiare dhe politike që në mënyrë efikase t'u përgjigjet numrit të rritur të ankesave mbi heshtjes administrative;
- Publikim proaktiv të informatave mbi strukturën, politikës dhe buxhetit të çdo organ publik, në gjuhët që përdoren në vend, të publikuar në ueb faqe dhe në media.

Çdo segment i shoqërisë civile dhe mediat duhet që të bëjnë më shumë përpjekje për informimin e anëtarëve të tyre dhe qytetarët të cilat veprojnë si shtylla në të gjitha nivelet. Bashkëpunim efikas midis organizatave që punojnë për lirinë e informacioneve, organizatat e mediave dhe shoqata civile është e nevojshme për forcimin e aftësisë së tyre dhe aftësinë e qytetarëve për marrjen e informacioneve.

Qytetarë mirë të informuar mund të kontribuojnë më shumë për reformat integrative në BE për vendin. Kjo mund të arrihet vetëm me përpjekje të përbashkëta të institucioneve publike, mediave dhe shoqërisë civile.

Të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë diskutim sot, sidomos organizatave që e implementojnë projektin, Qendra për komunikim civil, Shkup dhe partnerëve të tyre Qasja në informacione, Spanjë dhe Rrjeti raportim hulumtues së Ballkanit, Shkup, u uroj punë të mbarë!

Ju faleminderit për vëmendjen!